

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.D, nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën paragrafi 1.4 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.102/2014 të datës 27.06.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit, mbrojtësi i tij avokat Y.K, si dhe të dëmtuarit D.Xh, me datën 12.02.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**A.D**, nga i ati E.. dhe nëna A.. e lindur ..., i lindur me datë ..., në ..., ku edhe tani jeton, në rrugën "...", nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 17.09.2013, rreth orës 17,30 minuta, në ..., në rrugën "...", i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D.Xh, që rezulton me pasoja të përkohshme në shëndet, në atë mënyrë që për shkak të një kontesti pronësor, derisa i pandehuri ishte duke rregulluar automjetin, del i dëmtuari ku fillojnë të fjalosen, e më pas e kap për fyte dhe e godet me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, dhe atë: ndrydhje dhe gërvishtje të indeve të buta në regjionin e qafës, gjoksit dhe të dy duarve,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën paragrafi 1.4 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,49 par.1 pika 1.1,50,51,52,73,74,75, dhe 188 par.3 lidhur me nën par.3.1 të KP-së, të akuzuarës i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale,

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 euro si dhe në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore në cilësinë e dëshmitarit dr. N.U shumë prej 50,00 Euro, dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari: D.(G) Xh., nga ..., rruga "...", pa numr, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Konfiskohet kaqavidhi si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.102/2014 të datës 27.06.2014, kundër të akuzuarit A.D, nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën paragraf 1.4 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Besim Susuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbetem në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.102/2014 të datës 27.06.2014, lidhur me veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, kundër këtu të pandehurit A.D. Gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës në tërësi është vërtetuar gjatë administrimit të provave në shqyrtimin e sotëm gjyqësor dhe në shqyrtimet e mëhershme. Ekzistimi i veprës penale si në aktakuzës, rrjedh nga fakti i deklaratës të dëmtuarit, si dhe nga deklarata e të vetë akuzuarit, i cili gjatë deklarimit të mbrojtjes së tij në shumicën e rasteve ka deklarata kundër dhënësve të cilat janë në kundërshtim me vet deklaratat e tij të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, e kjo me të vetmi qëllim që të shmange përgjegjësisë së tij penalo juridike. Andaj nga të cekurat, i propozoj gjykatës që pas vlerësimit të gjitha provave të administruara, si dhe deklaratave të dëmtuarit, dhe dëshmitarëve tjerë, si dhe provave materiale, të pandehurin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e me rastin e matjes të dënimit mbi llojin dhe lartësinë, të ketë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe rënduese.

Po ashtu si dënim plotësues, i propozoj gjykatës që ndaj të akuzuarit të shqiptohet edhe masa e konfiskimit të kaqavidhes si mjet me të cilin është kryer vepra penale, konform dispozitave ligjore.

I dëmtuari D.Xh në fjalën e tij përfundimtare deklaron. që si palë e dëmtuar parashtron kërkesë pronësore juridike, për lartësinë e të cilës shumë do të deklarohet dhe sqarohet konkretisht në kontest të rregullt civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit Avokat Y.K, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: konsideroj që në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe bindëse inkriminimi i të mbrojturit tim në këtë çështje penale, pra që i njëjti të ketë kryer veprën penale e cila është e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Deklaratat e dhëna në Stacionin policor, nuk mund të mirën si prova, ndërsa si provë duhet të mirët deklarata të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i mbrojturi im në mënyrë kategorike deklaron që nuk ka qenë ai që e ka sulmuar këtu të dëmtuarin, por i njëjti është mbrojtur nga sulmi i të dëmtuarit. Po ashtu edhe deklaratat e dëshmitarëve të dëgjua nga shqyrtimet e kaluara, vërtetojnë këtë fakt. Por nëse edhe për kundër këtyre të cekura më lart, gjykata gjen se në veprimet e të mbrojturit tim ka elemente të veprës penale, atëherë i propozoj gjykatës që edhe me një dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit, e kjo nga fakti duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat ndikojnë në llojin e lartësinë e dënimit, është person familjar, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, bashkë punimin e përgjithshëm që nga faza fillestare e kësaj çështje penale, andaj nga të cekurat propozoj si më lart.

I akuzuari A.D në fjalën e tij përfundimtare deklaro: e përkrahi dhe e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim avokat Y.K, dhe nuk kam tjetër çka të shtoj.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datë 17.09.2013, rreth orës 17,30 minuta, në ..., në rrugën "...", i akuzuari, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D.Xh, që rezulton me pasoja të përkohshme në shëndet, në atë mënyrë që për shkak të një kontesti pronësor, derisa i pandehuri ishte duke rregulluar automjetin, del i dëmtuari ku fillojnë të fjalosen, e më pas e kap për fyte dhe e godet me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, dhe atë: ndrydhje dhe gërvishtje të indeve të buta në regjionin e qafës, gjoksit dhe të dy duarve,

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës, dhe ate deklaratës të akuzuarit, të dëmtuarit, ekspertit N.U, dëshmitarëve A.D, D.B, Xh.T si dhe provave materiale ekspertizës mjeko ligjore të ekspertit mjeko ligjor dr.N.U të datës 16.03.2014, raportit mjekësor të Qendrës emergjence të spitalit regjional në Prizren, numër ... të datës 17.09.2013, raportit oficerit të policisë në Prizren me numër ... të datës 08.01.2014 deklaratës të dëmtuarit pranë Stacionit policor në Prizren me datën 22.11.2013, si dhe në shkresat tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se i akuzuari A.D me datën 17.09.2013, në ... në rrugën ... rreth orës 17,30, i ka shkakuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D.Xh, për shkak të kontesteve të mëhershme pronësore, ka filluar të fjaloset me të dëmtuarin, dhe më pas e ka goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkakuar lëndime të lehta trupore, lëndime këto si ndrydhje dhe gërvishtje e indeve të buta në regjionin e qafës, gjoksit dhe të dy duarve, më detalisht të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të ekspertit mjeko ligjor dr. N.U, dhe këtë e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetë dijshtëm për veprimet e vet dhe ka dëshiruar kryerjen e saj. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike. Nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të kryer nga ana e të akuzuarit dhe ate lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e vërtetoi në bazë të deklaratës të dëmtuarit D.Xh, i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.09.2015 deklaroi: Ne ditën kritike, nuk me kujtohet data e saktë po e di se ka qenë diku në muajin shtatorë para dy viteve, pas kthimit nga puna, jam ndalur në një lokal të lagjes për tu freskuar, dhe për të pushuar. Në një momente duke qenë në lokal, e kam vërejtur një automjet zyrtar të policisë, dhe nga i njëjti zbriti këtu i akuzuari A., dhe e vërejtja që i njëjti kishte qenë në polici për të dhënë deklaratë lidhur me një mos marrëveshje që e kishte pasur me disa kushëri të mi, për të cilën mosmarrëveshje unë isha njohur më herët. Kur e vërejtja A., ju afrova për ta pyetur për arsyen dhe shkakun se çka kishte pasur me kushërit e mi, e këtë në kuptimin më pozitiv, dhe duke kërkuar unë sqarim, i njëjti pa kurrfarë sqarimi, nga pjesa e brendshme e xhakës e nxori një kaqavidh, unë mbeta i habitur, dhe tentova në çdo mënyrë ta zmbropsi sulmin e tij. Me ka ra në dorën e djathtë, me kaqavidh, dhe ate në pjesën e pasme të bërrylit të djathtë dhe nga kjo kam pësuar lëndime trupore dhe ate gërvishtje. Kur e kam vërejtur fqinjët aty pari, kanë filluar të njëjtit të reagojnë për të na ndarë, dhe në këtë ndarje, unë kam kërkuar nga të njëjtit që të thërrasin policinë. Në zhurmën e krijuar në këto momente, ka dalë nga shtëpia edhe motra e të akuzuarit A., D.B, dhe e njëjta një herë në fillim mbeti e shqetësuar dhe pas pyetjes çka ka ndodhur kështu, e njëjta me ka sulmuar mua në pjesën e qafës,

dhe atë në mënyrë që me të dy duart me ka shtrënguar gjegjësisht me të dy duart me ka shtyer për të më larguar nga vëllai i saj. Qëllimi i saj ka qen për të na ndarë sipas bindjes sime, nga se e njëjta kur ka ndërhyrë nuk ka mundur të di a me ka sulmuar ai mua apo unë atë.

Në vazhdim i dëmtuari në pyetje e parashtruar nga i akuzuari, deklaron: Unë nuk kam ardhur në shtëpinë tënde për të kërkuar sqarim, sqarimin ta kamë kërkuar kur ke zbritur nga automjeti i policisë, dhe atë para lokalit gjegjësisht në pjesën e trotuarit. Nuk është e vërtet që kur ki zbritur nga automjeti unë të kam ardhur dhe të kam zënë për organe gjenitale duke të kërcënuar që mund të shkaktoj lëndim. Po ashtu nuk është e vërtet që kur ke dalur nga automjeti policisë unë të kam mbajtur mbrapa, ndërsa djali i axhës tim të ka goditur në pjesën e mbrapme gjegjësisht në veshk, po ashtu nuk është e vërtet që ti nuk i njeh djemët e axhës të mi, nga se ne kemi lindur dhe jemi rritur në atë lagje, dhe ate që nga viti 1968 jemi fqinje.

Unë personalisht nuk kam pasur asnjëherë mosmarrëveshje me të akuzuarin A., e po ashtu as sa e di unë familja jonë e ngushtë nuk ka pasur asgjë të keqe me të akuzuarin dhe familjen e tij, e çka ka të bëjë i akuzuari me probleme me djemtë e axhës të mi, ajo për mua nuk ka kurrfarë rëndësie, nga se ne jemi të ndarë familjarisht, ata i kanë familjet e veta pasurinë e vetë unë e kamë familjen e time pasurinë time.

Në fund theksoj që asnjë lloj sulmi, apo provokimi nga ana ime nuk ka pas për të akuzuarin A., dhe se si dhe qysh i ka raportet i njëjti me djemtë e axhës të mi, kjo nuk mundet me qen si shkake për të me sulmuar mua. Në fund theksoj që si palë e dëmtuar parashtrorë kërkese pronësoro juridike, për lartësinë e të cilës shumë do të deklarohem në kontestin e rregullt civil.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.02.2016, i dëmtuari deklaron: vetëm të theksoj që unë rreth orës 17,00-17,30, çdo ditë kalojë nga shtëpia e të akuzuarit, gjegjësisht nga lokalet që gjenden pranë trotuarit të akuzuarit, ngase ajo është rrugë publike. Jo vetëm unë por tërë banorët e lagjes, e shfrytëzojnë këtë rrugë publike, e cila gjendet pranë lokaleve e të akuzuarit, konflikti ka ndodhur konkretisht te vendi që është në trotuar, i cili gjendet pranë lokaleve të akuzuarit si ceka më lart, rrugë tjetër nuk kemi, e njëjta është publike, vetëm të kalonim nëpër rrugën kryesore gjegjësisht në asfalt. jo nuk kam hyrë në oborrin e shtëpisë të akuzuarit, jo në ditën kritike, por asnjëherë deri më tani nuk kam qenë në oborrin e shtëpisë e të akuzuarit, as nuk e di se si duket ai. Në ditën kritike, unë kam qenë duke kaluar pranë lokalëve të akuzuarit në trotuar, duke u kthyer nga puna, ashtu siç veprojnë dhe kalojnë çdo ditë. Unë kam qenë duke kaluar rrugës sime, e kam vërejtur këtu të akuzuarin, i cili më është drejtuar me fjalët “tash keni me e paguar shtrenjtë”, unë kërkova sqarim nga këtu fjalë të A., duke i thënë ngadalë se çka u bë, i njëjti menjëherë më sulmoi me kaqavidhë të cilën e kishte në xhakëtë.

Dëshmitarja D.B, në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.09.2015 deklaron: Ne ditën kritike, derisa vëllai im ka qen në stacionin policor për dhënien e një deklarate në polici, dhe deri sa i njëjti ka dashur të hynë në shtëpi, këtu i dëmtuari D.Xh se bashku me disa djemtë të axhës së vetë, emrat e të cilëve nuk me kujtohen, nga se janë shumë më të ri se unë në moshë, me kanë sulmuar vëllain tim në prag të shtëpisë.

Në vazhdim të deklaratës të vetë në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.11.2015, dëshmitarja deklaron: Ora e saktë nuk më kujtohet, por e di që ka qenë diku pas dite mund të them rreth orës 16,00-17,00. Arsyeja ka qenë që djemtë e axhës të këtu të dëmtuarit e kanë sulmuar babain tim në orët e mes ditës, personalisht këtu i dëmtuari nuk ka qenë, por kanë qenë djemtë e axhës të tij. Policinë e kanë ftuar fqinjët e lagjes. Unë kam tentuar ti ndaj, por nuk kam arritur, ngase kanë qenë një grup bukur i madh. Sa më kujtohet mua të njëjtit nuk kanë pasur ndonjë mjetë të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve, së paku unë nuk e kam vërejtur. Nuk e di konkretisht në cilin vend kam qenë në momentin kur ky grup e ka sulmuar vëllaun tim, por e di që vëllaun tim ma kanë sulmuar para derës së shtëpisë, e unë kam qenë pranë tij. Vendi konkret, ka qenë si kam cekë edhe në shqyrtimin e kaluar, edhe sot po e përsërisë, ka ndodhur para derës së shtëpisë - oborrit, ku ne i kemi lokalet tona, mund të them lirishtë mu në prag derës së oborrit. I lënduar ka qenë vëllau im, e po ashtu theksoj që këtu vëllau im ka pësuar më së shumti, i njëjti ka qenë i sulmuar nga grupi si ceka më lart i të rinjëve, djemve të axhës të dëmtuarit D.Xh, dhe nuk mund të kuptoj si mund të jetë i njëjti i akuzuar kur e sulmojnë 10-20 persona, mund të përfundoj që unë e kam vërejtur kur vëllaun tim e kam pshtetur për murrin e lokalit këta persona, dhe në mesin e këtyre personave ka qenë edhe i dëmtuari D.Xh.

Dëshmitarja në vazhdim në pyetje të dëmtuarit D.Xh, deklaron, ka qenë në vend të ngjarjes edhe ate pasi që ka ardhur nga puna, e vëllau im pasi që është kthyer nga dhënia e deklaratës në polici me rastin e sulmit ndaj babait tonë nga ana e djemve të axhës të dëmtuarit. Unë ju kam ndarë juve të gjithëve, fjala është për të dëmtuarin, konkretisht me emra nuk e di, qëllimi im ka qenë vetëm zbrapsja e sulmit ndaj vëllaun tim.

Unë kur kam dal në vend të ngjarjes, ti personalisht fjala është për të dëmtuarin D.Xhn, me djemtë e axhës tu, keni qenë 4-5 vetë, që e keni kapur vëllaun tim për qafe, dhe e keni mbështetur në lokal, lokalet janë pronat tona, askush nuk thotë që trotuari ku ju kaloni është i yni, por ai trotuar është para lokaleve tona, e mua aty ka qenë i sulmuar vëllau im, nga ana jote personalisht dhe nga ana e djemve të axhës tu, siç e përshkrova më lart.

Sa i përket mosmarrëveshjeve të mëhershme pronësore dëshmitarja deklaron: kjo është një histori e gjatë, ka qenë një mosmarrëveshje e cila është që një kohë të gjatë, për çështje pronësore, por ne si familje dhe unë personalisht kur asnjë të keqe nuk mendoj që i kam shkaktuar, përkundrazi mund të them lirishtë që vetëm ju kam ndihmuar. Si ceka më lart arsyeja ka qenë një mosmarrëveshje e kah motëshme pronësoro juridike, ngase sulmuesit të vëllaun tim me familjen e tyre pretendojnë që një trollë të cilin vëllau im dëshiron ta shes, është i tyre, por i njëjti është i yni. Ky është mendimi im, ndoshta ka pas dhe ka ndonjë arsye tjetër, por unë nuk e di.

Dëshmitarja A.D, në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.11.2015 deklaron: Në ditën kritike djali i axhës të dëmtuarit D., emrin e të cilit nuk e di, janë shumë të rri në moshë së pari ka hyrë vetë në oborr, dhe e ka thirrur djalin tim A..in, pas tij kanë ardhur edhe një grup, nuk e di saktë sa persona kanë qenë por me sy të lirë më duket që kanë qenë 7-8 persona, të cilët së pari më janë drejtuar mua se ku e kam djalin këtu A., dhe unë si nënë kam kërkuar sqarim, gjegjësisht arsyen se pse po e kërkojnë, të njëjtit mu përgjigjën që bashkë shorti im që e quanin baci J., ka ardhur në shtëpinë e tyre dhe ka dashur që ti djeg, dhe as unë nuk e kam të qartë çka kërkonin nga biri im. Në ndërkohë djali im u paraqit në oborr, dhe të njëjtit me të vërejtur e sulmuan, në ndërkohë

gjatë sulmit si ceka më lart, nga shtëpia dual bija ime D., e cila me mundësit e veta i ndau dhe i largoi sulmuesit e birit tim. Unë si nënë, si femër, në ato momente nuk isha në gjendje të ndihmoj birit tim. Pas një kohe nuk e di se kush dhe si e ka ftuar policinë, dhe të njëjtit pas një kohe shumë të shkurtër erdhën në vend të ngjarjes.

Paraprakisht djali im A. ka qenë në Stacion të policisë për të dhënë deklaratë lidhur me sulmin ndaj tij dhe burrit tim nga ana e djemve të axhës të dëmtuarit D., dhe në momentin kur i njëjti ka dashur të vijë në shtëpi, mu te pragu i shtëpisë i njëjti ka qenë i sulmuar si ceka më lart. Kam qenë në oborr të shtëpisë, kur ka ndodhur i tërë rasti,

Eksperti i mjekësisë ligjore dr. N.U, në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.12.2015, deklaroi: ekspertiza të cilën e kam përpiluar unë të datës 16.03.2014, është e bazuar në dokumentacionin nga shkresat e lëndës dhe ate me numër të protokollit ... të datës 17.09.2013, në emër të dëmtuarit D.Xh, të lëshuar nga Spitali regjional ....

Dëshmitari Xh.T – zyrtarë policor pranë Stacionit policor Alfa në Prizren, në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.12.2015 deklaroi: unë nuk kam qenë në vendin e ngjarjes me datën 17.09.2013, kur ka ndodhur rasti, unë kam qenë në zyrat e Stacionit policor ... në ..., në vend të ngjarjes ka qenë patrulla e kolegëve të mi. Në raste praktike patrulla e policisë pas lajmërimit shkon në vend të ngjarjes dhe varësisht nga situata e hasur në vend të ngjarjes veprohet në situatat të ndryshme. Në rastin konkret, vet i dëmtuari ka shkuar në spitalin regjional të Prizrenit, ku i është ofruar ndihma emergjence dhe pas ofrimit të ndihmës, i njëjti ka ardhur në Stacionin policor ku ka thënë deklaratë.

Unë kam qenë zyrtarë policor në njësitin e hetuesisë, nuk e di si ka qenë gjendja shëndetësore e të dëmtuarit D.Xh, para shkuarjes në spital, unë e di vetëm kur i njëjti ka ardhur në Stacionin policor për dhënien e deklaratës. Nuk mundem të deklarohej lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, pasi që procedura është pak e ngarkuar, së pari merren deklaratat nga njësia patrulluese, e pas kësaj vjen në hetuesi dhe fakti që ka kaluar një kohë bukur e gjatë nga rasti, nuk mund të shkruaj për gjendjen e të dëmtuarit.

Sipas mendimit tim kaqavidhi i cili është në shkresat e lëndës, patrulla e policisë e cila ka qenë në vend të ngjarjes me rastin e përpilimit të lëndës dhe dërgimit në njësinë e hetuesisë, të njëjtit ja kanë bashkangjitur shkresave të lëndës, andaj edhe i njëjti duhet ti takoj të dyshuarit, pasi që i njëjti është gjetur në vend të ngjarjes.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 08.12.2015, është bërë leximi i shkresave dhe ate: të ekspertizës mjeko ligjore të ekspertit mjeko ligjor dr. N.U, të datës 16.03.2014, raportit mjekësor të qendrës emergjente të spitalit regjional në Prizren, numër ... të datës 17.09.2013, raportit të oficerit të policisë në Prizren me numër ..., të datës 08.01.2014, deklaratës të dëmtuarit të dhënë në Stacionin e policisë në Prizren, me datë 22.11.2013.

I akuzuari A.D në shqyrtimin gjyqësor me datën 12.02.2016 në mbrojtën e vet deklaroi: po e njoh të dëmtuarin D.Xh, e njoh që një kohë të gjatë, po qe një kohë të gjatë kemi probleme me të dëmtuarin lidhur me disa çështje pronësore, konkretisht është fjala për një uzurpim të tokës nga ana e familjarëve të dëmtuarit familjes tonë, toka kontestuese është në emër të babait tim,

fjala është për një kontest para 20 viteve e më shumë, po në kohën kur ka ndodhur uzurpimi i pronës të familjes sonë unë kam qenë i mitur, babai im ka qenë në ndieni për këtë tokë të uzurpuar, dhe babai im ka kërkuar kthimin e kësaj toke dhe lënda është në gjykatë, me dëmtuarin konkretisht kemi pasur probleme familjare si ceka më lart, provokimet nga ana e të dëmtuarit dhe familjarëve të tij kanë qenë të vazhdueshme, unë paraprakisht kam qenë i sulmuar nga ana e familjarëve e të dëmtuarit, ka pasur aty edhe dëshmitar, por të njëjtit për shkaqe sigurie nuk pranojnë të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, unë absolutisht nuk e kam sulmuar të dëmtuarin, përkundrazi më ka sulmuar konkretisht i dëmtuari. Në momentin kur unë jam kthyer nga qendra e policisë ku kam qenë me një intervistë lidhur me një përleshje paraprake, me të afërmit e të dëmtuarit, rast ky që është paraqitur në stacionin policor, unë me automjetin e policisë jam kthyer në shtëpi, si kam zbritur nga automjeti i policisë, më ka dalur përpara këtu i dëmtuari, së bashku me djalin e xhaxhait të tij, emrin e të cilit nuk e di, pasi që i njëjti është në moshë më të re se unë, dhe më është drejtuar me fjalët paraprakisht ty policia nuk mund të të mbroj gjithmonë, dhe pas këtyre fjalëve më ka sulmuar. Në ndërkohë kanë dalur edhe familjarët e mi, dhe fqinjët. Konflikti ka ndodhur para derës së shtëpisë sime, tek prona ime, si ceka më lart si kam zbritur nga automjeti i policisë pas intervistimit, ka ardhur këtu i dëmtuari së bashku me djalin e xhaxhait të vet dhe më kanë sulmuar, po kaqavidhi ka qenë i imi, të njëjtin e kam pasur në xhep të xhaketës, pasi që paraprakisht kam qenë duke rregulluar automjetin tim. Por të njëjtin nuk e kam përdorur, konkretisht vendi i konfliktit ka qenë në pronën time, para derës së shtëpisë. konkretisht këtu i dëmtuari më ka sulmuar para derës, derisa në oborr më kanë sulmuar paraprakisht djemtë e xhaxhait të dëmtuarit, si theksova më lart që ky rast është paraqitur në stacionin policor, ndërsa sa i përket konfliktit me të dëmtuarit, e tëra ka ndodhur para derës së shtëpisë.

Në pyetje të dëmtuarit i akuzuari në vazhdim deklaroi, është fakt që trotuari është rrugë publike, po para trotuarit, në trotuar konkretisht, gjinden lokalet e mija. me ty personalisht, fjala është për të dëmtuarin jo nuk kam biseduar për çështjet e pa zgjidhura pronësore, me familjarët e tu po. Në momentin si ceka disa herë më lart, kur kam pasur konflikt me djemtë e xhaxhait të dëmtuarit, kam qenë duke rregulluar automjetin, kur ka ardhur policia, të njëjtin më kanë marr në stacionin policor për intervistë në vend të ngjarjes, pasi që kam qenë duke rregulluar automjetin, kaqavidhin e kam vendosur në xhaketë, dhe ashtu me kaqavidh në xhaketë kam qenë në stacionin policor për dhënien deklaratë, në vend të ngjarjes ka qenë duke më pritur i dëmtuari,

Të dëmtuarin nuk e kam parë në momentin kur kam qenë i sulmuar nga ana e djemve të axhës të dëmtuarit në përleshje, e kam vërejtur herën e parë të dëmtuarin në ditën kritike, në oborr të stacionit policor, unë kam dhënë deklaratë në Stacionin policor për çështjen e mëhershme të përleshjes, dhe pasi që djemtë e xhaxhait të akuzuarit, ishin pranë stacionit, zyrtarët policor për shkaqe sigurie më kanë përcjellë me automjetin e tyre zyrtarë deri në shtëpi. Kur kam zbritur para shtëpisë, e kam vërejtur këtu të dëmtuarin D.Xh. Theksoj në vazhdim që momenti kur e kam parë unë të dëmtuarin D.Xh pranë stacionit policor, dhe kur e kam parë për herë të dytë në ditën kritike para shtëpisë time, ka qenë një periudhë e gjatë kohore, ngase intervistimi im në Stacionin policor ka zgjatur diku rreth 40-45 minuta, e derisa jam kthyer në shtëpi, mund të them që tëra ka ndodhur për një orë, koha kur kam qenë i sulmuar nga djemtë e xhaxhait të dëmtuarit ka qenë diku rreth dy orë para se të ndodh rasti me të dëmtuarin D.Xh.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit D.Xh, i cili në deklaratën e vet në tërësi përshkruan në mënyrë të qartë që në ditën kritike nuk ka pasur kurrfarë konflikti as mosmarrëveshje me të akuzuarin. Në ditën e cëkur kur ka ndodhur konflikti, i njëjti ka qenë duke u kthyer nga puna, dhe rrugës për në shtëpi ka kaluar pranë shtëpisë dhe lokaleve të akuzuarit, në të cilën rrugë kalon çdo ditë gjatë shkuarjes në punë dhe ardhjes nga puna. Në momentin e cëkur është takuar me të akuzuarin, i cili në atë moment ka zbritur nga automjeti zyrtarë i policisë, ngase i njëjti kishte qenë për dhënie të një deklaratë në Stacionin policor për shkak të një përleshjeje paraprake të mëhershme po atë ditë me djemtë e xhaxhait të dëmtuarit. Shkak për sulm dhe shkaktim të lëndimeve të lehta trupore të dëmtuarit, kanë qenë mosmarrëveshjet e mëhershme të një kohe të gjatë të familjarëve të dëmtuarit me familjen e të akuzuarit, dhe këto mosmarrëveshje kanë qenë për shkak të çështjeve pronësore të pa rregulluara deri më tani në mes të këtyre dy familjeve. Në atë moment, të takimit të tyre, i akuzuari e sulmon të dëmtuarin, duke i shkaktuar lëndime trupore të përshkruara në ekspertizën e mjeko ligjore, dhe në raportin specialistik, po ashtu lëndimet e pësura të dëmtuarit nga i akuzuari i ka vërtetuar edhe eksperti mjeko ligjor i dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i njëjti ka qëndruar në tërësi pranë ekspertizës me shkrim të parashtruar kësaj gjykate nga vet ai, të cilat prova janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe në bazë të këtyre provave është vërtetuar në tërësi gjendja faktike, pasi që deklaratat e të dëmtuarit dhe provat materiale të cekura në tërësi përputhen në mes veti, të cilat prova janë bindëse për gjykatën, andaj gjykata në tërësi ja fali besimin provave të cekura, ndërsa sa i përket deklaratës të akuzuarit se kinse ai vet ka qenë i sulmuar nga këtu i dëmtuari, dhe se i njëjti ka vepruar në vetë mbrojtje, dhe se shkak i tërë kësaj ka qenë mosmarrëveshja e vazhdueshme me familjarët e të dëmtuarit lidhur me çështjet e pazgjidhura pronësore juridike, e po ashtu i njëjti në mbrojtjen e vet deklaroi që konflikti me të dëmtuarin ka ndodhur para shtëpisë së tij, gjegjësisht si deklaroi vet i akuzuari në pronën e tij, dhe kaqavidhi me të cilin e ka goditur dhe sulmuar të dëmtuarin ka qenë në xhepin e xhaketës, të cilën e kishte futur në xhaketë paraprakisht kur kishte shkuar në Stacionin policor për dhënien e deklaratës lidhur me mosmarrëveshjet gjegjësisht konfliktin që e kishte pasur me të afërmit e të dëmtuarit më herët në ditën e cëkur, diku rreth një orë më herët se konfliktin me të dëmtuarin. Po ashtu edhe deklaratat në cilësinë e dëshmitarëve të dëshmitarëve D.B, për ndryshe motra e të akuzuarit dhe A.D, nëna e të akuzuarit, të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, të njëjtat deklarojnë që vëllau i saj gjegjësisht biri i saj këtu i akuzuari ka qenë i sulmuar nga kushërinjtë dhe të afërmit e të dëmtuarit, deklaratat këto që sipas mendimit të gjykatës kanë të bëjnë më shumë me përleshjen e të akuzuarit me të afërmit e të dëmtuarit para se këtu i akuzuari ta sulmonte të dëmtuarin, dhe kjo kontradiktë e deklaratave vërtetohet edhe me faktin kur edhe vet i akuzuari deklaroi në mbrojtjen e vet që në momentin e konfliktit fizik me të dëmtuarin, i dëmtuari e ka sulmuar, dhe se nuk i cek fare personat e tjerë, por shton që në oborr e kanë sulmuar paraprakisht djemtë e xhaxhait të dëmtuarit. Pra në bazë të këtyre deklaratave kontradiktore të akuzuarit dhe të dëshmitarëve të cekura, deklaratat e të tilla gjykata nuk ja fali fare besimin, dhe nga të cekurat gjykata vjen në përfundim që qëllimi i këtyre deklaratave është në drejtim të asaj që të përjashtohet përgjegjësia penale e të akuzuarit dhe lirimi i tij nga aktakuza. Gjykata pas vlerësimit të gjitha provave së bashku, duke vlerësuar paraprakisht secilën provë veç e veç, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.



Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimin mbi konfiskimin e mjetit me të cilën është kryer vepra penale gjykata e bazoi në kuptim të nenit 115 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1010/2014 me datë 12.02.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari,**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.